



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 437 Prot.

Tiranë, më 28.03 2019

VENDIM Nr. 63, datë 18.03.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, datë 18.03.2019, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor të ri "Lepenica, 2019: dokumentimi dhe vëzhgimi arkeologjik në një strehë me art shkëmbor parahistorik (Shpella e Shkruar, Lepenica)"* drejtuar nga MA. Rudenc Ruka (IA) në bashkëpunim me Dr. Fernando Carrera (Shkolla e Lartë e Konservimit dhe Restaurimit të Bens Culturais De Galicia- Spanjë), në kuadër të Shkollës Doktorale të IA-së dhe Erasmus+, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor të ri "Lepenica, 2019: dokumentimi dhe vëzhgimi arkeologjik në një strehë me art shkëmbor parahistorik (Shpella e Shkruar, Lepenica)"* drejtuar nga MA. Rudenc Ruka (IA) në bashkëpunim me Dr. Fernando Carrera (Shkolla e Lartë e Konservimit dhe Restaurimit të Bens Culturais De Galicia- Spanjë), në kuadër të Shkollës Doktorale të IA-së dhe Erasmus+, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Ridokumentimi sipas metodave bashkëkohore me anë të fotogrametrisë dhe dokumentimit topografik i cili do të jepte një pamje ekzakte të gjendjes së kompozimit dhe marrëdhënies së brendshme të tij.
 - Marrja e kampionëve të pigmentit të përdorur për realizimin e pikurave do krijonte mundësinë për të hedhur dritë mbi teknikat e përdorura dhe do të ishte sugjerues për metodat e ruajtjes në ardhmen.
 - Vëzhgime arkeologjike në territorin përreth mund të japin dëshmi të vlefshme për sa i përket datimit dhe vet mënyrës së përdorimit të peizazhit arkeologjik të zonës.
 - Studimi synon të eksploroheh mundësitë për sa i përket konservimit shkencor të sitit si dhe rikuperimit të atyre pjesëve të dëmtuara në mënyrë që të rritet shikueshmëria e figurave për vizitorët e ardhshëm.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2019.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.

4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**